



Përndjekja e familjes Syku nga strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit

(Disa gjetje arkivore AIDHSH dhe AQSH mbi familjen Syku)

Burime: Dokumente arkivore 1945–1978



Hyrje historike

- **Bregu i Matës**, një ndër zonat më të zhvilluara bujqësore në perëndim të qytetit të Lezhës, u godit rëndë pas vendosjes së regjimit komunist për shkak të politikave të kolektivizimit dhe fushatës kundër të ashtuquajturve “**kulakë**”.
- Ndër familjet që u prekën më rëndë ishte **familja Syku** – e njohur për pasurinë, ndikimin dhe qëndrimin e saj të pavarur. Ajo u etiketua si “kulakë”, iu sekuestrua prona, u përjashtua nga ndarja e tokës dhe u ndoq për vite me radhë nga strukturat politike dhe operative të kohës.



Reforma Agrare dhe sekuestrimet (1945–1953)

- Gjatë Reformës Agrare u sekuestruan rreth **5000 dynym tokë** dhe **400 krerë bagëti** në pronësi të **familjes Syku**.
- Në dokumentet arkivore përmenden gjithashtu familjet **Coku** dhe **Beg Keqi**, të cilat u shpallën “kulakë” dhe u përjashtuan nga ndarja e tokës

Me 2-XI-1945 përshtje matje Pylli të
Gjon Niki Likut dhe Mirash B. Likut.

Me 3-XI-1945 3-4 e 5 filloj matje e
tokave të pronarit Dodi Pres Likut në
të cilin u lënë një ronesë e madhe matjeje
mbasi tokat gjeri parcela të largëta deri
në 200 larg njera tjetra dhe në rreth
Rionpa u lënë dy përshtje. Në mesin
mbasi ju dhe e drejtë e tij 380 dyqym
Trungu dhe 6 familje, dhe u morën
shënimet e veçanta.

Me 5-XI-1945 filloj matje e tokës të Dodi
Liqitë Dodi, i dyshimit, për sasinë e vertetë
të tokës ju mbeten kryesisht mbasi i përmirë.

Imac Voleshi
Aplikimi i Reformës Agrare në Krahun Gjyshi Lumin

Nr. Emri e mbiemni vend. i brykut t'instaluem	shumë	brymë	Lodue		Rr. rreth	Vrejte
			me naty. ose kat. ose dijim. aulim.	me naty. ose kat. ose dijim. aulim.		
25. Gjon Nik Likut	6	30	711	758	2	
26. Dodi Pres Likut	6	35	722	753	2	
27. Gjon Nik Likut	1	30	6	53	60	153 shite 20 Trunq.
28. Dodi Pres Likut	1	35	6	53	60	153 " 20 shite Trunq.
29. Fron Lin Gjoni	1	12	2	53	40	73 20 shite 2 shite m...

(208)

Rapporte punet mbi aplikimin e Reformes Agrare ne
Katundia Tale e Gryke Lumit.

Prirja e Populli Me rastin e aplikimit te reformes ne kta dy katunde po-
pulli e priti me nji gezim te pa tregushem, Po sa kemi mbrijt ne katu-
tund kemi gjete krejt popullin te mbledhun te Shkolla e Katundit e
dhe dikush ne nji mendyre dikush ne nji tjetet, tregojshin gezimin e
kesaj dite dhe priteshin me pa durim qe ti caktohet toka e tu bate
zot mbi i saj bashke me robt e shtepis, dhe te gjitha premtoshin se
plori i hekurt i kontrolluam nga prondart dot t'a bajshin te Ilorini
me pune dhe me djera, mbasi zot jam bujk dhe prondar ne token t'eme
qi Pushteti Popullor po qe ep familjes s'eme.


met e tokave. Pa fillue punen Komiteti me paraqiti listen e Katundit e
bujk ka katundi bashk me te dhe nji Koperativ Bujqesore. Me njihere
filluam nga punimi gjate cedimit te tokave jam mundue shum qi
Gabinet pa dashje qi mund t'u baheshin me i bufishe sa ma teper, dhe
per me bujqit ishim nji dhe jemi mundue mbrenda ligjit shtet dhe t
udhzimeve qi kemi marre nga Zyra me i kondenu te gjith por me gjith
ket mund te jen ne 5-6 bujq nji pa kenaqsi per ceshtje se nuk i ka
ra ku kishin dishieren mbasi toka ishte kene cedue ma pare. Por dhe
veprimi i kryem ishte i parapam prej Komitetit.

Antaraja e Komitetit. Gjat punimeve te kryeme Komiteti kje shum aktiv, i
drejt dhe i pa anshem (mbasi shpesh here i kam provue indirekt) dhe
instalimi i o'do bujkut u bante me nji vendim te tyne tu u studiu
skenaja e bujkut. Antaraja e krahit dhe sasija e frymve. etj. Pra ky
Komitet meriton nji lavdate te posaqme per punimin e kryer
Komitet kjen: Frrok Deda, Kol Pretashi, Thoma Thimi, Gjergj Kola, e
Ndue Zefi e Kol Doda e Marika Prenga.

Ne shtet perfundimit punimeve nuk ndodhi as nji incid.

tekniku i Bujqesis:
(Injac Breshi)

9-XI-946



5) Prel Syku, i biri Koles dhe i Katerines, i dat-lindjes 1932, lindur e bannues ne katundin Gryke e Lumit te rrethit Lezhes, ushtar ne repartet e Garnizonit Tiranes, fshatar i pasur, pa parti, me kombesi e shtetesi Shqiptare, me 5 klase filllore, i pa denuar ndonji here, i pa martuar, i arrestuar me daten 21/V/1952 ne burgun e Tiranes.

Element kulak i prekur rande nga reformat me 3000 dylm toke dhe si i tille qysh ne kohen e luftes dhe mbas glirimit ka uryer Pushtetin Popullor, ka mbajtur lidhje te ngushta me kriminelin Abas Kupin e tjere, dhe ne vitin 1950 bie ne kontakt me Llesh Kolecin dhe pranon per te marre pjese ne grupin Anti Komunist te kryesuar nga Kogo Kondili ku tregon aktivitet duke shtuar radhet e grupit dhe duke ju marre foto-grafit si mbas udhezimeve; faj ky qe parashikohet nga neni 3 Nr. 7 te ligjes Nr. 372.

Ka mbledhur informata me karakter ekonomik e politik ne favor te agjentures Titiste me anen e Nue Shyrit dhe te dergoheshin Komitetit travntar Shqiptarja e Lire. Faj ky qe parashikohet nga neni 3 Nr. 10 te ligjes Nr. 372.

Ka dezertuar nga radhet e ushtrise popullore per te kaluar ne nji shtet armik siç ishte Jugosllavija Titiste deri sa u kap; faj ky qe parashikohet nga neni 308 K.P.

Kabere agjitacion e propogande kundar Pushtetit Popullor duke biseduar me elementa te tjere dhe duke shperndar trakte me permbajtje shpirtore siç ka parashikohet nga neni 308 K.P.

Brendshme, mbasi studjova materialet ne ngarkim te Llesh Sykut, i biri i Gjokes dhe i Katerines, i dl. 1947, lindur e bannues ne katundin Gryke e Lumi te ketij rrethi, me arsim 7 vjeçar, i martuar, me profesion murator, i pa organizuar, me origjine shogerore fshatar i pasur (te cilesuar kulak) dhe aktualisht kooperativist, i internuar per 5 vjet kohe ne vendin e banimit, me kombesi e shtetesi shqiptare ;

Ji nga këto vusajtjet tona dhe tashë shpejtë ka për të ardhur se këta janë prishur edhe me Kinën dhe puna e të tyreve ka për të marrë fundë me siguri tashë shpejtë, e tjera biseda për të cilat kanë folur ne procesin tjetër që kanë dhënë për Lekën. - - - - -

Pyetje: Në sa ditë gjë tjetër të na thonë për Lekën ose pjestaret e tjer të familjes së ketijë ? - - - - -

Përgjigje: Me Lekën dhe familjen e ketijë kemi shkuar gjithmonë mirë jo vetëm unë Ahmeti por edhe baba timë Begë Kadri Keçi ka shkuar mirë me axhen e Lekës i quajtur Ded Preq Syku (sotë i vdekur). Ne shtëpinë e Ded e Zef Preq Syku në shtator të vitit 1944 deri në gjysmën e Mentorit 1944 ka ndenjur Abaz Kupi me gjithë një Ushtri prej 500 - 600 Ushtrë që përfaqësonin dhe luftonin për triumfin e partis Zogiste dhe gjatë kohës së të qëndrimit të Abaz Kupit në shtëpinë e ketijëve kanë ardhur dhe mjaftë persona të tjerë krerë të reaksionit, të cilët vinin për tu takuar dhe konsultuar me Abaz Kupin si Ded Coku ishë Gjeneral i Italo-Gjermanve, Kryetri i Çetnikve të Malit Zi, që kështu të fundit ja kanë kallzuar vetë rrugën për tek shtëpia e Ded Preqit ku ishte strehuar z Kupi e tjer që mua nuk më kujtohet. - - - - -

ne moshe te kaluare. Kam kushri te pare Gjok Kol Sykun, icili ka djale
Llesh Sykun qe eshte i arestuare. Gjithashtu kam kushrinj te larget
djemt dhe nipat e Gjon Sykut, te cilet jane kulake. Djemt e Gjonit ja

D E T Y R A T:

Set per set nuk ka rast takimi ne personat e sipermes
dhe prandaj nuk ju dhane. Ka per objekte te tjera.-

S Q A R I M:

1) Lek e Gjergj Zef Syku jane keshigjesh kulak dhe
kane një valla te arratisur.-

2) Prel Kol Syku ka qene demuar 20 vjet politik
dhe set i lire ne punë ne Laq te rrethit Krujes.-

3) Mirosh Nikoll Meku kulak ne 2/3

4) Dy personat te rrethit Shkoder nuk njihen nga
ana e jone pervec se ne sykajt kane lidhje familjare.-

M. Operative:

- Dergje Kruje dhe Shkoder te dergohet nga nje kende.
- Shkoder te shkruajne ne se aje ka mundesi ndonjehere
nga keta mund te ndihmoje ne drejtim te kulakeve te sipermes.-



Veprimtaria e Sigurimit të Shtetit ndaj familjes Syku

- Oficerët përgjegjës: Piro Visari, Miltiadh Olldashi, Stavri Labi, Bajram Ciro.
- Raporte për '**përpunim aktiv**' të familjes Syku.
- Tentativa për rekrutim të disa anëtarëve.
- Izolim dhe survejim i vazhdueshëm i të tjerëve si elementë armiqësorë.
- Qëllimi: kontroll dhe shkatërrim i ndikimit të familjes në komunitet.

Përgjigje: Biseda armiqësore unë kam bërë edhe me kushëririn tim të largët Prel Kol Sykon. Prela qysh nga viti 1962 e deri para dy vjetësh ka punuar në qytetin e Laçit si xhamaxhi. Tash ai banon në fshat dhe me punë është në Ndërmarrjen e Ndërtimit Lezhë. Në vitin 1951 Prela është dënua me 16 vjet burg, siç e di unë, për arratisje. Ai është axha i Llesh Sykut që është arrestuar para mejet.

Duhet të ketë qënë muaji Korrik 1977, disa ditë pas arrestimit të Lleshit, një ditë unë me Prelën po kalonim rrugës për në punë. I pari e hapa unë bisedën, i thash Prelës: e arrestuan edhe Lleshin. Prela më tha këto gjana presim nga këta dhe e kishte fjalën për Pushtetin Popullor. Duke vazhduar bisedën ai më tha që kjo këtu tek në nuk është drejtësi, këtu në Shqipëri nuk ka liri. Në fshatarëve - tha Prela - na qesin jashtë radhet tek ushqimet, nuk të qas kush të marrish ushqime. Në qytet tha ai, jeta është më e mirë, kurse në fshat jetohej keq. Unë e mora fjalën dhe i thash se me të vërtetë në fshat jetohej keq, njerëzit në kooperativë punojnë shumë dhe marrin lekë më pak, normat në kooperativë janë më të mëdhaja nga ato të ndërmarrjeve. Në Tiranë, i thash unë Prelëska gjashtë lloje bukëesh, kurse në fshatarëve në Lezhë nuk na japin as një lekë bukë, nuk na japin as sheqer, as kafe dhe as miell. Na thonë, i thash unë atij, që e kenë listën në fshat, por në fshat merr ushqime vetëm ai që ndodhet afër, nuk ngelet më për të tjerët. -----

V E N D I M

bi marrjen në përpunim aktiv 2/A me tendencë agjitacion e propagandë kundërrivolucionare të Prel Kol Sykut.

Unë punëtori operativ i Degës Punëve të Brëndshme Lezhë Firo Visari mbasi studjova materjalet në ngarkim të Prel Kol Sykut nga fshati Grykë-Lumi i rrethit Lezhë,

G J E T A:

Sa është i biri i Kolës dhe i Katerinës, i datëlindjes 1932, lindur dhe banues në Grykë-Lumi, me arsim fillor, me profesjon bujq, aktualisht murator, me origjinë shoqërore fshatar i pasur dhe mbas qllirimit cilësuar kullak, i dënuar 20 vjet me heqje lirie për krimin e agjitacionit dhe propagandës e për tentativë arratisje, i paorganizuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.

Para qllirimit të vëndit Prela ka qënë me moshë të vogël, edhe gjatë luftës N-QI nuk i dihet ndonjë aktivitet, ndërsa mbas qllirimit janë përfshirë në reforma agrare në rreth 2000 dyqan tokës dhe 300 kreza bagëti. Në vitin 1953 Prela është dënuar me 20 vjet heqje lirie për agjitacion e propagandë dhe tendencë arratisje. Mbas daljes nga burgu është futur në MSH.N. Lej dhe më vonë ka ardhur në Lezhë ku punon si murator në M.SH.N. Prela ka për grua Lule Gjeksën nga katundi Rrailë i kësaj rrethi familje me qëndrim e përbërje të keqe politike, të shpronësuar nga reforma agrare. Prela ka vëllezër Gjok dhe Noc Sykun banues në Grykë Lumi dhe cilësuar kullak, ka një Llesh Gjok Sykun arrestuar kohët e fundit për agjitacion e propagandë. Të gjithë të afërmit dhe njerëzit e fisit të tij Prela i ka me përbërje të keqe politike dhe të cilësuar kullak.

Në ngarkim të tij kemi të dhëna agjenturale operative ashtu dhe një implikim nga Prel Kol Syku i arrestuar kohët e fundit për agjitacion e propagandë. Kështu në procesin e datës 7/9/1977 Pali deponon se Prela i ka thënë: "Sa të jetoj udhëheqsi kryesor gjallë, nuk duhet të presim asnjë shprehje se është shumë i zgjuar dhe nuk ja heq njësi dhe as me luftë nuk ja leverdis njeriu për të ardhur këtu mbasi këtu nuk ja përto janë sypse e lind që po ti kapin nuk kanë shqëpin, sepse kanë bërë shumë krime dhe këto sypse ose nesër do ti paguajnë." Gjithashtu ai u përbindi dhe më lart, në ngarkim të tij kemi dhe 8 të dhëna agjenturale të cilat bëjnë fjalë po për agjitacion e propagandë. 5 të dhëna janë nga B.p. "Kthesa", 2 nga b.p. "Elida" dhe 1 nga b.p. "Mizri i kuq"

shtrëngues ndaj tij është i plotë dhe nga ana tjetër, nga lidhjet e tij për veprimtari të përbashkët armiqësore janë arrestuar 5 persona dhe këto janë ekzakt në betuesi e nuk kanë dalë në gjyq, momente këto të mundshme për të vënë në pozitë të plote përbashkët. Në këtë kandidat egzistojnë mundësitë e plote për të mbajtur në lidhje konspirative nga ana e jonë sepse punon në N.S.H.N. Lezhë jashtë fshatit e në këtë mënyrë gjatë ardhjes në punë si dhe mbas lënies së punës, realizohen lehtë takimet me të gjithëshkruar rubet konspiracioni i punës. Ka në të njëjtën kohë, mundësi reale për të kryer detyrat që do t'i ngritohen sepse me një pjesë të mirë të personave që mendojnë të përpunojnë, punon sëbashku në një objektiv. Ndërsa me të tjerët, ka mundësi për t'i takuar e përpunuar, në kohën e lirë jashtë punës, kur shkon në fshatin e tij pranë familjes.

PLANI I TËRHEQJES NË BASHKËPUNIM.

Dega ushterake e rrethit Lezhë ka për të kryer punime në fshatin Blinisht të zonës së Zadrimës si dhe të drejtën e dërgimit për të kryer zbatim në raportet jashtë rrethit e sidomos në raportet e brigadës së Tripojës sepse kryhen punime mbrojtëse rreth hidroqendrës të Fierzës. Nga ana jonë do të shfrytëzohen këto momente dhe do të bisedohet me shefin e degës ushterake për të dërguar në këto punime tre persona nga i njëjti raport ku bëjnë zbatim një ndër të cilët do të jetë dhe kandidati. Dy nga personat e thirrur do të dërgohen në Blinisht për të punuar në veprat mbrojtëse të qetëve vullmetare kurse kandidati do të pajiset me dokumentet përkatëse për të shkuar pranë komandës së raportit nr. Tripojë duke e bindur për nevojën e veprimtari të tij atje sepse që rreth do të dërgojë persona për të kryer zbatim në punimet mbrojtëse në këtë raport mbasi punimet do të bëhen shpejt për mbrojtjen e veprës së madhe të hidroqendrës. Përparsë shefit të degës ushterake nevoja e dërgimit të tyre në këto vende do të legjendohet në këtë mënyrë: këto ditë do të vihet në funksion fabrika e letrës në Lezhë dhe meqënëse këto persona janë me të kaluar të keqe dhe në të njëjtën kohë për t'i dalë përpara ndonjë veprimtari të mundshme armiqësore si dëmtim apo sabotim, është e nevojshme që këto të largohen për 10-15 ditë sepse atje do të jenë të itoluar e nën disiplinën ushterake e kështu nuk do të kenë mundësi të largohen. Duke i larguar këto persona në kryejmë dy detyra: nga njëra anë evitojmë ndonjë veprimtari të mundshme armiqësore dhe nga ana tjetër këto persona kryejnë zbatimin e detyrueshëm ushterak.

Dy ditë përpara nisjes së kandidatit për në Bojren Curri, do të shkohet nga ana e jonë për të biseduar me komandën e raportit nga e cila do të marrim një fletë zbori e firmosur dhe e vulosur për kryerjen e 15 ditëve të zborit në atë raport e cila do të mbahet nga ne për tje

e propagandës.

Në 3/4/1978 ky objekt është arrestohet sekret për ta tërhequr agjent me material detyrim, por gjatë procesit të tërheqjes nuk u zbatuhen plotësisht dhe agjenti i arrestuar për agjitacion e propagandë dhe me vendim të gjykatës popullore të rrethit Lezhë, dënohet me 10 vjet heqje lirie, dënim të cilin e kreu në raportin 303 Spaq.

Meqënëse veprimtaria armiqësore e tij në agjitacion e propagandë u vërtetua si nga jashtë shteti dhe nga lidhjet në betuesi, nuk konkludua për të bërë përpunimin e shtetshëm të tij në burg, dhe për këtë arsye donja formulare u arkivua në kartotekën e Degës P. Brendshme Lezhë me vlerë ruajtje 10 vjet.

Kohët e fundit Prela ka dalë nga burgu dhe ka ardhur me banin për tje në fshatin Gryk Lami.

Duke u nisur sa sipër, që Prela ka qëndër i dënuar dy herë për veprimtari armiqësore e duke gjykuar në tërësi për të, ka ardhur dhe mundësit për t'u riaktivuar përsëri në veprimtari armiqësore.

VENDOSA

Që Prel Kol Sykun nga fshati Gryk Lami, të marrë në kontroll operativ 2/B, për llogari të drejtimit të K/Zbulimit, duke marrë di- se nga masat agjenturore operative për kontrollin e tij.

FUNKTORI OPERATIV
MILITARI GILDASHI

SHAFI I SHKËRIMIT
STAVRI LARI

Nga dokumentet arkivore dalim në përfundim se:

- Rasti i **familjes Syku** përfaqëson një shembull tipik të përndjekjes klasore në fshatrat e Shqipërisë gjatë regjimit totalitar.
- Sekuestreime, burgosje dhe internime për të zhdukur shtresat si kjo familje.
- **Qëllimi:** kontroll i plotë shtetëror mbi individin dhe pronën.

Kujtesa e rasteve si ai i familjes Syku është thelbësore për të kuptuar natyrën e represionit komunist në Shqipëri një regjim që kërkoi të sundonte jo vetëm përmes frikës, por edhe përmes fshirjes së kujtesës historike dhe shkatërrimit të lidhjeve shoqërore tradicionale.

Dokumentimi dhe studimi i këtyre historive ndihmon në ruajtjen e kujtesës historike, në nxitjen e reflektimit shoqëror dhe në ndërtimin e një kulture demokratike që respekton dinjitetin dhe të drejtat e njeriut.



(15) 3.75

Fotog. e te arratisurit Nue Syku
dale me gjetur ne
banesen e velleit te tij te pande
hurit Lek Syku

Kartvizite derguar nga i a-
rratisuri Erak Ceku, bijes
se tije Pashkes, gjetur ne
shtepine e Lek Sykut.

God bless you
at this Christmas
And keep you in His care
And may He guide you
with His love

Always and evermore--
God give you every Christmas joy
That comes from heaven above
And may He always bless your life
With His unending love

Shkruar ne ditene e Pashkes.
Si largjet te hapen muret dhe ti
perzihet me shpirtin e shenjte, shpirtin
te shenjte, qe te udhetoj drejte shpirtit te shenjte.
e kete. Githashe besh i qete.
Githashe besh i qete. Githashe besh i qete.
Githashe besh i qete. Githashe besh i qete.



3/6
(16)

Fotografi e te arratisurit Nue Syku e gjetur ne shtepine e velleit
te tij, te pandehurit Lek Syku